



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 19-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30. 05. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete

4. Avni Olluri, drejtor i DA
5. Rasim Hasani, drejtor i DKA
6. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
7. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
8. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
9. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
10. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
11. Vlorë Limani-Hajnuni DSHMS
12. Vlorë Krasniqi, zyrtarë ligjorë
12. Besart Troshupa, zyra e informimit
13. Haki Avdiu,
14. Bekim Krasniqi, OJQ "YAGR"
15. Kimete Jashanica, OSBE
16. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 30 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 18-të e Kuvendit.
2. Propozim vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë 2019-2023.
3. Propozim vendim për shfuqizimin e pjesërishërishëm të vendimit 1Nr. 464-123 të datës 20. 06. 2016
4. Propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave
5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr-463-67906 të datës 22.12.2017

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit dhe fillimisht i njoftoi lidhur me zëvendësimin e një anëtari të ri nga radhët e LW-së. Tha se në vend të Selatin Retkocerit është anëtar i ri Alban Salihu. Dhe e ftoj anëtarin e ri të jap betimin.

Pastaj Kryesues i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Nazmi Krasniqi, tha se vërejtje nuk kam. Por që tri seancat e kaluara kemi kërkuar që të jetë një pikë e rendit të ditës, të debatohet për arsimin apo një informatë. Arsyeja se po përfundon një vit shkollor e ka kaluar gjysëmvejtori i parë dhe nuk kemi informatë për suksesin.

Megjithatë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës, Kryesuesi vuri në votim dhe pas votimit me 30 vota për 1 kundër kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, deshta me ditë se a është duke u punu Rregullorja të cilën e ka propozu kolegu Fadil Sopa për rregullimin e orarit të punës subjektet afariste që dita e diel të jetë ditë pushimi.

Nehat Terpeza, me 26 maj është mbajtur turniri tradicional në Ribar të Madh ku ka pasur numër të madh të qytetarëve. Andaj kërkoj pasi jemi në fazën e planifikimit buxhetor të investohet në shtimin e ulëseve të tribunave dhe për rreth fushës.

Sistemi digjital në komunë është i mirë por është mirë që e njëjta të bëhet edhe në QKMF. Ka disa muaj që bibliotekisti është pensionuar që ka punuar në shkollën “Kadri Beba” dhe nga ajo kohë biblioteka nuk punon nxënësit po detyrohen me u furnizuar me libra në Lipjan. Kisha dashtë me ditë kur do të riaktivizohet biblioteka.

Egzona Bytyqi, deshta të ngris një shqetësim timin personal për vonesën e barnave esenciale dhe materialit shpenzues në ambullantën ku punoj unë në fshatin Shalë, mungesa e shiringit, gjilpërës dhe fashave, ku pacientët janë detyruar t'i blejnë vetë këto.

Ramiz Qeriqi, kam një kërkesë për këtë semaforin që është prish ose të rregullohet ose të ndalohet krejt. Te vend kalimet po bëhet një punë e mirë. Por kam një vërejtje te punëkryrësit të cilët nuk po e kryejnë punën si duhet pasi po shtrojnë asfalt mbi asfalt dhe nuk është kah kryhet puna si duhet. Dashta me ditë sa kemi participu në këtë iftar ne si komunë.

Bashkim Budakova. po e ngris një shqetësim të qytetarëve që në rrugën “Gjergj Fishta” aty te shkolla fillore “Vllëzërit Frashëri” për çdo ditë në ora 13 dhe 16 kemi frekuentim të madh të kësaj rruge, andaj kisha kërku nga organet kompetente që në këto termine të mos ketë qarkullim të veturave në këtë rrugë.

Albulena Kelmendi, fillimisht ju uroj kandidatit Alban Salihut punë të mbarë. Unë dua ta ngris një çështje. OJQ”YAHR”, në një pronocim për medija nuk e dijë se a me qëllim apo pse për propozimin për ndarjen e mjeteve për eskurzion në seancën e kaluar që ne kemi qenë kundër kjo OJQ”YAHR” votën tonë e ka paraqitë si anonime. Edhe në seancën e kaluar e kemi kërkuar një raport për punën e psikologëve nëpër shkollat e Lipjanit. Disa rrugë të pa ndriçume siqë është rruga “Hamëz Jashari” në qytet qe një kohë të gjatë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, puna e qenëve endacak është një problem për qytetarët. Deshta të pyes drejtorin z. Ilir Tashollin, e kemi dhënë një parcellë në shfrytëzim është një projekt dhe deri ku ka shkuar puna e këtij projekti për qenët endacak.

Arben Salihu, pasi jemi në periudhën e KAB-it, kam një pyetje për drejtorin nëse ka mundësi për nënat amvise me i subvencionu me një shumë simbolike në mënyrë që mos të ndiejn veten të anashkaluar. Çështja e dytë që dua ta ngris është për drejtorin e inspektoratit megjithëse është qështje e shendetësisë, shumë barna në vend shiten pa receta, apo pa përshkrimin në gjuhën shqipe apo në gjuhën serbe aq më tepër kur janë me banderola.

Lulzim Rrustemi, përshëndetje për të gjithë Albanit i uroj mirëseardhje dhe punë të mbarë në Kuvend. Kërkoj nga ju Kryesues i Kuvendit me ju përmbajtur planit të punës qe e kemi aprovuar në Kuvend. Po ashtu për drejtorin e bujqësisë kërkoj një informatë për dobritë dhe mangësit e subvencioneve për vitin e kaluar.

Argjend Tasholli, fillimisht asambleistit të ri i uroj mirëseardhje dhe punë të mbarë. Unë do t'i numroj disa projekte që janë kërkesë e qytetarëve. Ndiriçimi i rrugës “Arif Aliu”, i rrugës “Ilirida” që është i rrezikshëm nga qenët endacak. Finalizimi i kanalizimit të fshatrave Gadime, Gllavicë dhe fshatrat e komunës tonë. Ndiriçimi i rrugës dhe troturati në Gadime të Epërme te rruga “Eksodi 99”.

Imri Ahmeti, në emër të ekzekutivit asambleistit të ri i uroj punë të mbarë. Shkelzeni e ngriti një çështje të rregullativës lokale për një orar të punës të përkufizuar e ngritur nga asambleisiti Fadili. Do ta fusim në agjendë por nuk e dijë si do të pritët nga publiku. Duhet një debat edhe me bizneset së shpejti do ta formoj një grup punues për ta proceduar si temë. Nehati për qështjen e ulëseve në fushën e futbollit të hapur në Ribarë të Madh, Nehat ke të drejtë duhet me u fut në buxhet kur të vjenë dita e propozimeve të buxhetit duhet të na përkujtoni që mos të harrojmë. Në Ribar të Madh po ndërtohet edhe një sallë e sporteve. Ai turnir meriton me u mbështetë dhe do t'i shikojmë mundësit financiare për t'i ndërtu edhe ultëse tjera përveq atyre që janë. Te çështja e bibliotekës që e ngriti Nehati në Ribar atje sipas rregullativës e kemi drejtorin dhe një zyrtar tjetër administrativ nuk mundemi me marrë edhe një bibliotekist. Shumë shpejt përmes drejtorit të arsimit do ta rregullojmë këtë çështje me staf ekzistues e jo me staf të ri.

Samaforat me të drejtë u ngrit kjo çështje nuk kemi mundësi automatike ligjore me rregullu. Është hera e dytë që po dëmtohet, kemi kompaninë siguruese të automjeteve. Kompania e sigurimeve do t'i rimbursohet komunës por ka procedura. Ne po përpiqemi me komunën që kanë kontratë për mirëmbajtjen për defekte por jo për diken që dëmton komplet semaforin. Mendoj që

brenda javës do të filloj me u riparuar ky semafor në bazë të informatave që i kam. Te çështja e pengesave të reja nuk jam në dijeni a i kanë shtruar ujë apo jo. Në projektin publik ka pozicione me të cilat është dashtë me u krye dhe nuk e ka krye duhet me ndërmarrë masa drejtorët dhe menaxherët e projekteve.

Ajo çka është me rëndësi Lipjani ka me pasur shenjëzim horizontal të ri do të ketë pengesa të reja, ndriçim të ri të këtyre pengesave dhe disa asete tjera që nuk janë në asnjë komunë të Kosovës. Iftari i mbrëmshëm nuk kanë qenë dy ftesa por kanë qenë tri, një nga organizata KATAR, një nga Komuna dhe një nga Bashkësia Islame. Ku komuna për këtë iftarë ka participu me 1300€ e këto ju kanë dhënë BI, për t'u mbuluar, pjesën tjetër e ka mbuluar organizata KATAR.

Rruga para shkollës që e ngriti Bashkimi është e vërtetë që frekuentim të jashtëzakonshëm nuk e dijnë cila është mundësia me zgjidh atë situatë. Dhe me e mbyll rrugën në atë kohë është problem i madh, kjo është bërë për shkak të popullzimit të madh të Lipjanit. Në seancat e ardhshme duhet me debatuar këtë punë se Lipjanit i duhet edhe një shkollë tjetër.

Qenët endacak është një problematikë në nivel qëndror, nuk është përgjegjësi e jona financiarisht mbulohet agjencioni veterinar i Kosovës edhe këtë vit ka një shumë të mjeteve që i është dhënë agjencionit që të trajtohen në gjithë territorin e Kosovës qenët endacak edhe në Lipjan e kanë obligim. Ndriçimi publik jemi mundu të jemi azhur në këtë çështje e kam fjalën për ndriçimin publik ekzistues. Por nëse ka raste të tilla lajmëroni te organet zyrtare të komunës është kompania që duhet me i sanuar këto raste.

Flora Limani-Hajnuni, sa i përket pyetjes së Nehatit, Kuvendi e ka miratuar një projekt me propozim të Kryetarit në vitin e kaluar që këtë vit është në procedurë të prokurimit për rendin, radhën e pritjes siqë është në administratë. Për çështjen që e ngriti doktoresha, ligjëruesi lider i mjekësisë familjare është doktori. Nëse mungojnë barnat përgjegjës është doktori. Nuk ka asnjë arsye qytetari me ble barna të listës esenciale siqë është sidomos për stomatologji dhe laboratorët, shiring, gjilpër, sistem apo infuzion pasi ato nuk mungojnë. Në vitin e kaluar i kam caktuar infermier të përkohshëm në QKMF që ka për detyrë me shikuar mungesën e barnave esenciale në ambulanta dhe në QKMF, doktori e ka për obligim me inspektuar ambientin dhe mungesën e barnave esenciale.

Egzona Bytyqi, materiali që është në QKMF pse nuk është shpërndarë me kohë për QMF në Shalë. Çdo herë materiali ka ardhur me datën 06.

Vlora Limani-Hajnuni, doktoreshë kërkesa për material nuk mundet me u bo sot e sot me u furnizuar e sidomos për ato punkte që janë largë siqë është Shala. Kërkesa për material duhet me u bërë së paku 10 ditë përpara.

Argjend Tasholli, Kryetar pres përgjigje që t'i parashtrova nga ju për kërkesat e qytetarëve të fshatit Gadime.

Ilir Tasholli, disa projekte që u përmenden nga Argjendi në çdo seancë këto projekte janë të gjitha të planifikuara në kornizën afatëmesme buxhetore.

Lulzim Rrustemi, është mirë si Kuvend me pasur parasysh, për një person që ka shetit dhe në Lipjan. Është mirë me ju sygjere shkollave, prindërve, familjeve të kenë kujdes me rrjete sociale edhe portaleve sepse këto janë një dëm i përgjithshëm. Lipjani ka dalë jo mirë në media. Në si Kuvend është mirë me shpreh shqetësimin tonë dhe me reagu publikisht.

Megjithatë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 18-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjithatë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 18-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat prezent 30 votat për,

Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 18-të e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë 2019-2023.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Avni Ollurit, drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, çdo Rregullore e cila i shërben transparencës së komunës ne e përkrahim. Por kërkesa ime që ka qenë edhe në KPF. A mund të bëhet diçka që seancat e Kuvendit të përcillen nëpërmes të faqes së fejbukut.

Majlinda Sylejmani, ne si grup parlamentar i LDK-se e përkrahim planin e veprimit të transparencës. Me theks të veçant prokurimi publik i cili mundëson çasje të drejtpërdrejtë në kontrata të hapura të vendosura në web faqen e komunës.

Afrim Miftari, asambleistit të ri të Vetëvendosjes i deshiroj mirëseardhje. Sa i përket këtij propozim vendimi ne si grup parlamentar konsideroj se është një dokument i rëndësishëm i komunës tonë. Ky dokument është i bazuar në legjislacionin në fuqi ne i japim mbështetje këtij propozim vendimi.

Egzona Bytyqi, ne si grup e mbështesim planin e veprimit të transparencës me të vetmin qëllim që opinionin publik të informohet në kohë me punën e ekzekutivit, legjislativit dhe administratës komunale. Ky plan është i kompletuar dhe ajo çka ne deshirojmë të ketë zbatueshmëri në praktikë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, para se të aprovojmë këtë plan të veprimit mbi transparencë dua të ju rikujtoj se Kuvendi edhe më herët e ka miratua edhe një Rregullore mbi transparencën në Komunën e Lipjanit. Gjatë kësaj periudhe e kemi një zyrë të informimit e cila është vetëm në shërbim të Kryetarit të Komunës, duke mos informuar qytetarët e Komunës së Lipjanit. Në mbledhjet e Kuvendit i ipet hapsirë vetëm Kryetarit të Komunës dhe ky është niveli i transparencës në komunën tonë.

Avni Olluri, sa i përket pyetjes së Albulenës do t'i shikojmë sa kemi mundësi të bëjmë një transmetim edhe në rrjetet sociale. Për këtë do të konsultohemi me AJTI-n dhe zyrën ligjore.

Lulzim Rustemi, është një dokument i mirë i rregulluar dhe i plasuar. Por e vërteta qëndron që këto dokumente nuk po zbatohen. Ne kemi një mandat që asnjë peticion i qytetarëve nuk është shqyrtu në këtë Kuvend dhe kemi mungesë të jashtëzakonshme të transparencës. Prandaj transparenca nënkupton përgjigjen ndaj qytetarëve, ndaj peticioneve dhe kërkesave. Në konsulltim me grupin punues që e kemi pasur një debat me shefat e grupeve punuese ka qenë një propozim që edhe drejtorët të mbajnë konferenca për shtyp. Nëse kishte me hy edhe ky propozim që drejtorët të mbajnë konferenca për shtyp dhe t'ju drejtohen qytetarëve atëherë ky plan do të ishte i kompletuar.

Avni Olluri, sa i përket planit të transparencës është duke u zbatuar 100% në praktikë. Sa i përket raporteve mujore të drejtorive faktikisht të secilës drejtori publikohen në web faqen zyrtare të komunës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se një ndryshim i vogël që ka qenë gabim teknik te faqja 9, pika 13, te kolona e fundit, teksti që është dhe po ashtu publikimit të procedurave nga Komuna e Lipjanit për subvencionet bëhet në bazë të dispozitave dhe ligjeve në fuqi kalon në pikën 14.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë 2019-2023 me këtë ndryshim të vogël që është gabim teknik, dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me të gjitha votat prezent, aprovoi këtë:

**VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË
NË KOMUNË 2019-2023**

Neni 1

MIRATOHET, Plani i Veprimit për transparencë në Komunën e Lipjanit për perioden 4 (katërvjeqare) 2019-2023.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit për transparencë në Komunë 2019-2023.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Administratë.

Neni 4

1. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë, 15Nr.016-20221 i datës 30.03.2018.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim vendim për shfuqizimin e pjesërishërishëm të vendimit 1Nr. 464-123 të datës 20. 06. 2016

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdinit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, është mirë atyre që ju kemi nda prona, atyre që kanë qenë të papërgjegjshëm me ua marrë pronat. Çka në rast se nuk përgjigjet Standard Benzi qysh mundemi me e marrë këtë pronë kur e dijnë se është në hipotekë.

Hyra Bytyçi, në emër të grupit parlamentar të LDK-së i urojmë mirëseardhje anëtarit të ri në Kuvendit komunal. Ndërsa sa i përket propozim vendimit për shfuqizim, inkurajojmë për këtë iniciativ. Sa i përket shfrytëzuesve të ri të pronave komunale nëse ata nuk i përmbahen afateve kohore dhe marrveshjeve sipas kontratës duhet të bëhet shfuqizimi i tyre.

Nazmi Krasniqi, unë mendoj se është çështje e mirë por e vonuar. Me sa e dijë unë në kontratë që ka pasur komuna është dashtë me i kriju disa kushte. Por duhet të kihet kujdes në të ardhmen se kujt po i ipen këto prona.

Albulena Kelmendi, ne në vazhdimësi kemi përkrah iniciativa të tilla me ua marrë pronat kompanive apo personave që nuk ju kanë përmbajt kriteret të parapara. Kështu që çdo vendim i tillë që vije kështu e ka përkrahjen tonë. Ajo çka presim nga ky ekzekutiv të mos ketë selektime për marrjen e pronave ndaj personav apo kompanive në baza militante, partiake.

Afrim Miftari, ky vendim dhe vendimet paraprake nuk janë të lehta të merren nga ky Kuvend. Po shohim këtu dy vendime që po kërkohet shfuqizimi i pjesërishëm. Ky Kuvend duhet të marrë një vendim në bazë të neneve të formuluar nga ato kontrata në të cilën shkruhet

nëse pala nuk ju përmbahet kushteve të kontratës mund të shkëputet njëanshëm kjo kontratë. Andaj ne e mbështesim këtë propozim vendim.

Ukë Kryeziu, është një nga vendimet që është sjellë në Kuvend si çështje herë pas here nga asambleistët dhe është përgjegj ekzekutivi për disa çështje që kanë çen problematike për këtë vendim të marrë. Me propozim të drejtorit që të futet në nenin 3 dhe 4 ajo ishte që të hiqet barra nga Kuvendi apo Komuna e Lipjanit për shlyerjen e asaj kredie meriton përkrahje dhe mbështetje.

Nazmi Krasniqi, unë do të apstenoj për arsye se janë dhënë pronat. Por kam një pyetje për drejtorin, a ka bisedua me pronarët e pronave. Pasi pronarët edhe pas shfuqizimit kanë të drejtë me vepru edhe me gjykatë, prandaj unë pres vendimin e gjykatës.

Arben Salihu, sa i përket kësaj pike kam një propozim. Në të ardhmen të hartohet një Rregullore që përmes këtyre kontratave në mënyrë automatike të shkëputen, pas kalimit të afatit dhe mos të ketë nevojë të vije prap në Kuvend. Nëse nuk i përmbahen afateve ligjore.

Shkelzen Hajdini, ishte një pyetje farë mase duhet të merret që kjo pronë të hiqet nga hipoteka. Është neni 3 dhe 4 që shpjegon ku kërkohet shfrytëzuesi ta largoj nga hipoteka. Po ashtu Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër duhet të filloj procedurat.

Sa i përket pyetjes se a keni bisedua me pronarët. Janë shkresat që i kemi shkëmby me shfrytëzuesit. Neve nuk na lejohet të bisedojmë privatisht. Shfrytëzuesit e pronave kanë qenë të informuar është raporti në zyrën pronaro juridike që prona të hiqet nga hipoteka. Ishte një konstatim dhe u tha se çfarë zhvillimi ekonomik kemi. Komuna e Lipjanit renditet mirë në zhvillimin ekonomik është viti i dytë që shpallet nga USAID. Komuna numër një në indeksin e konkurrueshmërisë për zhvillim ekonomik. Qështje selektive ju garantoj se nuk ka, por ka qështje profesionale. Në menagjimin e pronës komunale jemi në top komuna më të mira.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, paraprakisht do të lexoj pas pikës 2 shtohet pika 3 obligohet shfrytëzuesi "Standard Benz" SH përfaqësues nga Fahri Retkoceri t'i kryej obligimet ndaj bankës në mënyrë që organi kompetente komunale ta liron parcelën e cekur nga hipoteka me të cilën është ngarkuar deri me datë 03.06.2023. Pika e 4 që shtohet pas 2. pika 3 tash pika 4 obligohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për kthimin e parcellës 164-23 në pronësi në librat publike TSH Kuvendi komunal Lipjan pas lirimit nga hipoteka. Pika 3 që ishte bëhet pika 5 dhe pika 4 që ishte bëhet pika e 6.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 30 votat për, 1 apstenim, aprovoi këtë:

VENDIM PËR SHFUQIZIMIN E PJESËRISHËM TË VENDIMIT 1NR.464-123 TË DATËS 20.06.2006

I. SHFUQIZOHET pjesërisht Vendimi 1Nr.464-123 i datës 20.06.2006 i Kuvendit Komunal Lipjan për aprovimin e raportit të punës së komisionit për vlerësimin e konkursit për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të tokës komunale P-71409036-00164-18 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arë e klasit 4-të me sipërfaqe prej 15092m² Zona kadastrale Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite për ½ Shpk "Lindi Cmp" dhe "Pajtimi Company", si dhe tokës komunale P-71409036-00164-23 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arë e klasit të 4-të me sipërfaqe prej 15000m² Zona kadastrale Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite "Standard-Benz Sh".

II. AUTORIZOHET Kryetari i Komunës që në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, të marr Vendim për shkëputjen e kontratave për shkak se shfrytëzuesit e cekur të pronës komunale nuk i'u kanë përmbajtur obligimeve të përcaktuara në kontratë dhe me të njëjtin të njoftojë Kuvendin e Komunës. Shkëputja e kontratave do të bëhet për shfrytëzuesit e pronës komunale si vijon:

- a) Kontrata 1Nr.464-163 dt.27.07.2006 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme P-71409036-00164-18 në vendin e quajtur “Branjesh” me kulturë arë e klasit të 4-të me sipërfaqe prej 15092m² Zona kadastrale Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite për ½ Shpk “Lindi Cmp” dhe “Pajtimi Company” përfaqësuar nga Ramiz Ajeti dhe Ilmi Konushevci.
- b) Kontrata 1Nr.464-154 dt.26.07.2006 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme P-71409036-00164-23 në vendin e quajtur “Branjesh” me kulturë arë e klasit të 4-të me sipërfaqe prej 15000m² Zona kadastrale Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues për 99 vite Standard-Benz Sh, përfaqësuar nga Fahri Retkoceri.

III. OBLIGOHEM, shfrytëzuesi Standard Benz Sh, përfaqësuar nga Fahri Retkoceri që menjëherë t'i kryej obligimet që i ka ndaj bankës në mënyrë që organi kompetent komunal ta liron parcelen e cekur nga hipoteka me të cilën është ngarkuar shfrytëzuesi i cekur deri me datë 03.06.2023.

IV. OBLIGOHEM, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për kthimin e parcelës 164-23 në pronësi në librat publike P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN pas lirimit nga hipoteka.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim,Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspektion.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Shkelzen Hajdinit,drejtor i DEZH, i cill në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, në faktë kisha dashtë Kryesues një paqartësi personale me u qartësu. Drejtori e elaboroj dhe e përmendi për zgjedhjen e këtyre anëtarëve. Dy nga ekzekutivi një nga shoqëria civile dhe dy nga subjektet politike. Por këtu nuk shkruan nga subjektet më të mëdha politike. Unë po mendoj që është e specifikume në Ligj. Kisha dasht me ditë pse nuk është e specifikume përbërja.

Sefer Tasholli, përbërja e komisionit është në bazë të Ligjit Albulen. Është e kuptueshme se në komisione është fuqija e votës që është në Kuvend dhe nuk ka nevojë me u shënu.

Hyra Bytyçi, propozon Fatime Krasniqin për anëtare të komisionit.

Argjend Tasholli, propozon Egzona Bytyqin për anëtare të komisionit.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, atëherë pas propozimeve kemi këtë përbërje të komisionit:

1. Avni Olluri dhe Imer Rrustemi nga ekzekutivi
2. Fatime Krasniqi dhe Egzona Bytyqi nga subjektet politike dhe
3. Arlind Gashi nga shoqëria civile.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, 3 apstenime, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

Neni 1
Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Avni Olluri, nga ekzekutivi i Komunës, anëtar
2. Imer Rrustemi, nga ekzekutivi i Komunës, anëtar
3. Fatime Krasniqi, nga radhët e subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, anëtare
4. Egzona Bytyqi, nga radhët e subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, anëtare
5. Arlind Gashi, nga sektori joqeveritar lokal, anëtar

Neni 2
Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3
Detyrat e Komisionit

Komisioni shqyrton ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës afatshkurtër dhe afatgjatë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019 dhe akteve nënligjore që do të derivojnë nga ky ligj. Komisioni për ankesa bën shqyrtimin e ankesave brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit mirëpo ky afat mund të ndryshojë pas hyrjes në fuqi të akteve tjera nënligjore nëse aktet nënligjore përcaktojnë ndonjë afat tjetër.

Neni 4
Punët administrative - juridike të Komisionit

Punët administrative juridike të Komisionit për realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj dhe akte nënligjore do të kryejë Zyra Kryetarit të Komunës - Sektori pronësor - juridik.

Neni 5
Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për shqyrtimin e të gjitha ankesave që kanë të bëjnë me procedurën e zbatimit të një Njoftimi publik, do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit të ankesave për 15Nr.463-67914 i datës 22.12.2017.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr-463-67906 të datës 22.12.2017

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, 2 apstenime, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT 15Nr.463-67906 TË DATËS 22.12.2017

I. SHFUQIZOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.463-67906 i datës 22.12.2017.

II. Shfuqizimi i Vendimit të cekur në nenin i të këtij Vendimi bëhet me qëllim të harmonizimit me dispozitat e Ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019 përkatësisht me nenin 17 paragrafi 6 i cili përcakton që për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet Komisioni vlerësues.

III. Procedurat për dhënien e pronave të paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, të filluara sipas Vendimeve paraprake të miratuara në Kuvendin e Komunës dhe të shpalluara paraprakisht nga Komisioni vlerësues do të vazhdojnë dhe do të përfundojnë nga i njëjti Komision, ndërsa në të ardhmen për secilin Vendim paraprak që do të miratohet në Kuvendin e Komunës do të nxirret Vendim për formimin e Komisionit vlerësues konform dispozitave të Ligjit.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11,³⁰

Ekstraktin e hartoi
Rrahim Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi